



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 519/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.07.2017 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Al - Dok” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-12448-05-11-2017, me objekt “Mirëmbajtje objekte ndërtimore, imjantistike e pajisje mobilimi”, me fond limit 850.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 22.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Librazhd.

Ankimues:

“Al – Dok” sh.p.k.
Adresa: Udenisht, pranë Hotel Odesa, Qafë Thanë, Pogradec.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Librazhd
Adresa: Rruga “Jakup Biçaku”, Librazhd.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.05.2017, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-12448-05-11-2017, me objekt “Mirëmbajtje objekte ndërtimore, imjantistike e pajisje mobilimi”, me fond limit 850.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 22.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Librazhd.

II.2. Në datën 22.05.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 25.05.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Leka” sh.p.k.	558.540	lekë (pa TVSH), skualifikuar
2. “Al-Dok” sh.p.k.	630.000	lekë (pa TVSH), skualifikuar
3. “Hasballa” sh.p.k.	664.220	lekë (pa TVSH), kualifikuar
4. “Doksani-G” sh.p.k.	781.840	lekë (pa TVSH), kualifikuar

5. “Mega-Plast-2L” sh.p.k.

nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.4. Në datën 25.05.2017 operatori ekonomik “Al-Dok” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në këtë procedurë prokurimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

[...]

Nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim pika 2.3.4. Mungon vërtetimi për shlyerjen e taksave vendore për çdo vendndodhje ku ushtron aktivitet sipas njësave administrative në Shqipëri për vitin 2015,2016, sipas adresave të vendeve të ushtrimit te aktivitetit te pasqyruar ne Ekstraktin e historikut të shoqërisë.

II.5. Në datën 26.05.2017 operatori ekonomik “AL-Dok” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike. Ankesë e cila është refuzuar nga autoriteti kontraktor me arsyetimin për korrigjimin e datës së ankesës e cila ishte 24.11.2016.

II.6. Në datën 30.05.2017 operatori ekonomik “AL-Dok” sh.p.k. ka paraqitur ankesën e korrigjuar pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, me arsyetimin si më poshtë vijon:

Për sa i përket arsyes së mësipërme u sqarohet se: Operatori ekonomik “Al – Dok” sh.p.k. nuk ka filjale të tjera në të gjitha njësitë administrative në Shqipëri, përveç njësisë administrative Bashkia Pogradec, ku ne kemi marrë vërtetimin që nuk kemi detyrime. Duke ju referuar QKB dhe Ekstraktit që nga themelimi i shoqërisë nuk kemi detyrime në asnjë njësi vendore në territorin shqiptar. Prandaj kërkojmë nga ana e autoritetit kontraktor të anulohet vlerësimin nga ana e Komisionit.

II.7. Në datën 01.06.2017, nëpërmjet shkresës me nr. 63/14 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën.

II.8. Në datën 01.06.2017, operatori ekonomik ankimues “Al-Dok” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik sipas të njëjtave pretendime si në autoritetin kontraktor.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr. 63/19 prot., datë 07.06.2017, protokolluar me tonën në datën 07.06.2017, me objekt “Dërgim informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit dhe informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në autoritetin kontraktor në datë 30.05.2017 dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në datë 01.06.2017. Autoriteti kontraktor në informacionin dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik pretendon se *“operatori ekonomik “Al – Doc” sh.p.k. më datë 01.06.2017 ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik... ankimuesi është ankuar në KPP pa u njohur me përgjigjen e AK drejtuar me shkresën tonë nr.63/14 prot, datë 01.06.2017 e cila është dorëzuar në zyrën postare Librazhd datë 01.06.2017 ora 12:00.”* Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik arsyeton se, për sa kohë është e pamundur të vërtetojmë momentin kur operatori ekonomik ka marrë përgjigjen për shqyrtimin e ankesës nga autoriteti kontraktor, vendos të shqyrtojë në themel pretendimet e operatorit ekonomik “Al-Doc” sh.p.k.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Al – Dok” sh.p.k. për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike me arsyetimin se *Operatori ekonomik “Al – Dok” sh.p.k. nuk ka filjale të tjera në të gjitha njësitë administrative në Shqipëri, përveç njësisë administrative Bashkia Pogradec, ku ne kemi marrë vërtetimin që nuk kemi detyrime. Duke ju referuar QKB dhe Ekstraktit që nga themelimi i shoqërisë nuk kemi detyrime në asnjë njësi vendore në territorin shqiptar*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në Shtojcën 6, *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”*, pika 2.2.3 rezulton se nga autoriteti kontraktor është kërkuar:

Dokument me të cilin provohet se janë shlyer detyrimet vendore per vitin 2015, 2016, 2017 lëshuar nga administrata tatimore vendore. Vërtetimi për shlyerjen e taksave vendore për çdo vendndodhje ku ushtron aktivitet sipas njesive administrative ne Shqiperi per vitin 2015,2016, 2017 sipas adresave te vendeve te ushtrimit te aktivitetit te pasqyruar ne Ekstraktin e historikut te shoqërisë.

III.2.2. Nga verifikimet, në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Ekstrakt i regjistrimit tregëtar dhe Ekstrakt Historik i regjistrimit tregëtar i shoqërisë “Al-Dok.” sh.p.k., lëshuar në datë 14.04.2017;*
- *Vërtetim Nr.321 Prot, datë 13.03.2017, për likuidimin e detyrimeve për taksat vendore, lëshuar nga Bashkia Pogradec.*

III.2.3 Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit sa më sipër, si dhe verifikimit të të dhënave të subjektit në Ekstraktin Historik të QKB konstaton se zyra qendrore e shoqërisë “Al-Dok” sh.p.k., për periudhën 2015 – 2017, është në adresën: Komuna Udenisht, Qafë Thanë, pranë Hotel Odesa;

III.2.4. Në cilësinë e autoritetit përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe interpretimit një herazi të tyre, për kriteret të cilat nuk janë parashikuar në mënyrë të shprehur

(eksplicide) në LPP dhe në aktin normative në zbatim të tij, por që i lihen në dorë autoritetit kontraktor ti vendosë në proporcion me natyrën dhe vëllimin e kontratës autoriteti kontraktor, ka parashikuar në mënyrë eksplicide detyrimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik mbi dorëzimin e dëshmimeve se kanë shlyer të gjithë detyrimin e taksave vendore për vitet 2015, 2016, 2017, sipas adresave të vendeve të ushtrimit të aktivitetit të pasqyruar në Ekstraktin e Historikut të shoqërisë.

III.2.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik "Al-Doc" sh.p.k., dhe nga Ekstrakti Historik i QKB, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues ka deklaruar se kryen aktivitetin e tij në ish - Komunën Udenisht, e cila me ndarjen e re territoriale sipas Ligjit Nr.115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", kjo komunë përfshihet në Njësinë Administrative Pogradec. Në përmbushje të kërkesës së autoritetit kontraktor operatori ekonomik ankimues ka paraqitur Vërtetim Nr.321 Prot, datë 13.03.2017, lëshuar nga Bashkia Pogradec, më anë të cilit vërtetohet se operatori ekonomik "Al - Doc" sh.p.k. nuk ka detyrime pranë Bashkisë Pogradec, të lindura në zbatim të ligjit "Për sistemin e taksave vendore". Meqenëse vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të taksave vendore pranë Bashkisë Pogradec është lëshuar në vitin 2017, rrjedhimisht vërtetohet se ky operator ekonomik nuk ka detyrime edhe për vitet e kaluara 2015 dhe 2016.

III.1.6. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."

III.1.7. Neni 12 "Regjistrimi dhe Liçensimi" i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar parashikon se: Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

III.1.8. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, operatori ekonomik "Al - Doc" sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Al - Dok” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-12448-05-11-2017, me objekt “Mirëmbajtje objekte ndërtimore, imjantistike e pajisje mobilimi”, me fond limit 850.000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 22.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Librazhd.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Al - Doc” sh.p.k. dhe të korrigjohet shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e këtij vendimi brenda 10 ditëve, në përputhje me parashikimet e Vendimit nr. 482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit, për Vitin 2017”.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Al - Doc” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1042 Protokolli

Datë 01.06.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha